



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.867/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Mileković-anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “TERMOVISION SHPK”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Sabri Azemi B.I-Raketa”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në Shkolla” me nr. të prok: 616-19-4071-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më datën: 18.12.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “TERMOVISION SHPK”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në Shkolla” me nr. të prok: 616-19-4071-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në Shkolla” me nr. të prok: 616-19-4071-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues:“TERMOVISION SHPK”-Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “TERMOVISION SHPK”-Prishtinë,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 02.12.2019 me nr. 867/ 19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në Shkolla” me nr. të prok:616-19-4071-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi i Komunës së Prishtinës,duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,7, 59, 60 si dhe nenin 61të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.12.2019, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt.12.12.2019,lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim: OE ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë “ pretendon se KUVENDI I KOMUNES I PRISHTINS, nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,sipas OE ankues pasi që e ka shpallur fitues OE “Sabri Azemi B.I. 23 Prishtinë” dhe pretendon se AK-së duhet të ketë në konsideratë qëllimin e këtij ligji ku dihet se qëllim i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase , më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë . Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është te sigurojnë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike , duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si

OE i pa suksesshëm dhe shpallja fitues e OE i cili ka ofertuar me çmim më të lirë është në harmoni me nenin 1 të LPP-së . Andaj, ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar .

OE ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë pretendon se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,sipas OE ankues . Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve ,andaj trajtimi i OE ankues i pa suksesshëm nuk është diskriminues ,por është transparente dhe në harmoni me nenin 7 të LPP-së . Duke u bazuar në këto fakte ekspertja shqyrtuese konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar ,sepse AK bazuar në arsyet e cekura më lart e ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmim më të lirë sipas poentimit ,dhe në atë mënyrë të gjithë OE i ka trajtuar në mënyrë të barabartë. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar .

OE ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë pretendon se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE ankues . Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve . AK-së fillimisht pas pranimi të vendimit të OSHP-së me nr.568/19 të datës 13.11.2019 ka themeluar komision të Ri-vlerësimit i cili ka vlerësuar dhe ka konstatuar se OE. i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe DT. Andaj në harmoni me nenin 59 të këtij ligji e ka rekomanduar për kontratë, të cilin e ka aprovuar edhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar .

Operatori ekonomik ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë pretendon se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së,sipas OE ankues . Ekspertja thekson se qëllimi i këtij neni është që të përcaktohet kriteri për dhënien e kontratës,OE që dorëzon tenderin e përgjegjshëm me çmim më të lirë,apo tenderin ekonomikisht më të favorshëm .

AK-së kishte përcaktuar kriteri për dhënien e kontratës,OE që dorëzon tenderin e përgjegjshëm me çmim më të lirë dhe te përshkrimi i çmimit i ka ndarë njësit duke i peshuar me poentim. Andaj edhe me rastin e Ri-vlerësimit AK-së ka vepruar konform kriterit të paraparë me NJ.K. dhe D.T. dhe në harmoni me nenin 60 të LPP-së . Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

OE ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë pretendon se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 61- i LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta ,sipas OE ankues , Neni 61 i LPP-së dhe rregullorja B57 ndër të tjera përcakton : 1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit,

sipas paragrafin 2. të këtij neni. 2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 2.1. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. 3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. Ekspertja shqyrtuese sqaron se ky nenë nuk është shkelur nga AK-së , sepse AK-së në këtë rast ka vepruar konform nenit 61 të këtij ligji ,ka pasur dyshime lidhur me disa çmime që i ka konsideruar të ulëta dhe ka kërkuar me shkrim sqarime konform paragrafit 1 të nenit 61 të LPP-së. Gjithashtu AK. ka pranuar shpjegimet nga OE. duke sqaruar se ka favore nga prodhuesi –zbritje 30% ma lirë për ato produkte , i njëjti ka ofruar edhe marrëveshjen të cilën e ka bashkëngjitur me letrën sqaruese dhe me atë marrëveshje vërtetohet se i njëjti ka zbritje (favore nga prodhuesi) 20% deri ne 30%,prej furnizuesit që është në harmoni me paragrafin 2.3 të këtij ligji të cekur më lart.

Gjithashtu me letër sqaruese ka sqaruar se ka në stok sasi të mjaftueshme e te cilat tani rrallë here përdoren sepse ky sistem i ngrohjes me naftë tani aplikohet shumë pak sepse i njëjti është model i vjetër dhe tregu është duke u orientuar nga disa modele me Pelet . AK. pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve konform paragrafit 3 të nenit 61 të LPP . Së e ka trajtuar sikur edhe tenderët tjerë të përgjegjshëm. Sa i përket pretendimit dhe sqarimit në formë tabelave nga OE. ankues se janë plotësuar tri kushtet e parapara me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët B57 ‘‘për tu eliminuar një OE. kjo nuk do të thotë se OE. me automatizëm eliminohet nga gara por duhet kërkuar sqarime siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji dhe nëse OE. nuk mundë të jap arsye bindëse dhe konform këtij ligji atëherë AK-së duhet ta trajtoj si OE. me çmime jo-normalisht të ulëta ,mirëpo te ky rast AK-së ka pranuar përgjigjeje bindëse dhe në harmoni me paragrafin 2.3 të këtij ligji të cekur më lart, andaj edhe me të drejtë e ka shpërblyer me kontratë . Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në arsyet e lartë përmendura, vlerësimi është bërë konform nenit 61 të LPP- së dhe rregullores B57 e cila gjendet në vebfaqen e KRPP-së, të Legjislacioni sekondar ‘‘B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët’’ andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik ankues HUDHË POSHT

SI TË PA BAZUARË (për arsyen që u çekën për secilin pretendim),dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues .

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.12.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 18.12.2019, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, si dhe ekspertja shqyrtuese,u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi deklaroj: Ne qëndrojmë në tërësi pran pretendimeve tona ankimore te parashtruara ne ankesën tone dhe njëkohësisht ju informojmë se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontrate OE-në i cili ka ofruar çmimi jo normalisht te ulëta e ku ky fakt edhe argumentuar edhe me tablete e cila është paraparë tek Rregullat për çmime jo normalisht të ulëta ku rezulton se të 3 kushtet i ka plotësuar OE për tu konsideruar oferta e tij jo normalisht e ulët.

Edhe Autoriteti Kontraktues është bazuar në tabelën e cekur me lart dhe njëkohësisht ka kërkuar sqarime për çmimet për pozicione jo normalisht të ulëta mirëpo çuditërisht Autoriteti Kontraktues edhe është pajtuar me kinse sqarimet që i ka bërë OE i rekomanduar për kontrate edhe pse i njëjti OE nuk ka dhënë asnjë sqarim detal dhe faktik se si mund te realizoj ketë kontrate dhe te jepe detaje për çmimet e furnizimeve që kanë të bëjnë me ketë AP.

I njëjti OE ka prezantuar vetëm një marrëveshje për furnizim të materialeve për ngrohje qendrore me Kompaninë Instal Engineering e ku në ketë marrëveshje nuk ceken detajet e çmimeve por vetëm thuhet se ne ofrojmë zbritje prej 20-30% te çmimeve për artikuj.

Mirëpo edhe nëse merret parasysh zbritja 20-30% në lidhje me produktet e ofruara përsëri rezulton se çmimet e ofruara nga OE janë jo reale jo ne harmoni me çmimet e tregut.

Ne si shembull mund ti prezantojmë Panelit pozicionin 39 furnizim me flakëhedhës ku ky furnizim ka te bëj me flakëhedhësin 273-415 KW ndera çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar është 350 Euro. Ne lidhje

me këtë pozë. Dhe produkt ne i paraqesim paneli një fature dhe flete dërgesë për te njëtin produkt ku ne jemi furnizuar nga i njëjti Kompani Instal Engineering e ku çmimi është 1.135.09 euro panelit i dorëzohet dëshmi. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontrate ne lidhje me produkte tjera ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta si psh.; për Enen 100 litra, 200-250 ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta mirëpo ne ju japim edhe një fakt se ky OE ka ofruar çmime manipulative në lidhje me këto pozicione që i përmendem edhe në tenderin që tash është zhvilluar dhe nënshkruar kontrata me te njëta paramasa ku për shembull për Enen 100 l ne procedurën e negociuar ka ofruar 100 euro ndërsa për atë të rregullt për të cilën jemi këtu ka ofruar 60 euro, panelit i paraqesim edhe kontratën që është nënshkruar ku mund të dëshmojmë edhe me faturë çmimin real të tregut për enen 200 litra e të cilën OE ka ofruar prej 70 euro ndërsa në e kemi faturën nga NTP Linda me çmim prej 150 euro me TVSh, i prezantojmë panelit kopjen e faturës ne lidhje me këtë pozë. Gjithashtu edhe sa i përket pozicioneve që ka të bëjë me pompa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta dhe njëkohësisht çmime manipulative kur krahasojmë çmimet e dhëna në këtë AP me çmimet e dhëna në procedurën e negociuar e ku është nënshkruar kontrata këto dite. Për shembull Pompa GHN prej 50-120 F në procedurën e negociuar është ofruar 540 euro ndërsa ane procedurën tash që jemi në seancë ka ofruar 210 Euro. Këto janë dëshmi të mjaftueshme se ky OE ka ofruar çmime manipulative dhe jo çmime që janë në harmoni me tregun dhe në asnjë mënyrë gjatë sqarimeve nuk ka arritur të dëshmojë se çmimet e dhëna nga ky OE janë në harmoni me çmimet e tregut. Një pompe e tilla në treg kushton përafërsisht 540 euro.

Gjithashtu dëshëm të sqarojmë për panelin për pompën për të cilën jemi duke folur tani ne jemi shpallur si tenderues me çmim jo normalisht të ulët në një AP tjetër që kemi ofruar çmim 200 euro ndërsa i njëjti OE ka ofruar 210 euro tash.

AP për të cilin ne e përmendem tani ka të bëjë me KK-RAHOVEC ku vendimi nga ana e Panelit është marrë i konsideruar si i tillë jo normalisht i ulët e ky vendim është i datës 06.08.2019 me nr. 322/19.

Sa i përket Autoritetit Kontraktues ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta për të njëjtat qeshje do të thotë që ka të bëjë me çmime jo normalisht të ulëta dhe tek kriteri me çmimin me të ulët (çmimi i peshuar) ku si shembull e japim AP Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçim publik me nr. PR616-19-2038-5-2-1 në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka eliminuar OE-te me çmime jo normalisht të ulëta edhe pse si kriter për dhënie të kontratës është paraparë çmimi i poentuar, ndërsa në ankesën tone nuk ka përdorur standardin e njëjtit e që rezultojnë që në jemi diskriminuar në këtë AP me nenin 7 të LPP-së.

Sa i përket ekspertizës së ekspertit shqyrtues në nuk pajtohem me konstatimet e saj sepse nuk kemi marr përgjigje konkrete në lidhje me çmimet jo normalisht të ulet mirëpo vetëm e ka përkrahur vendimin e Autoritetit Kontraktues si të bazuar dhe e ka arsyetuar se kanë marre përgjigje bindëse nga ana e OE të rekomanduar për kontrate edhe pse OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete në lidhje me kërkesën për sqarime.

Sa i përket çmimeve manipulative të ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate ku ky OE në këtë procedure ka ofruar çmimin e peshur prej 2.727.39 euro ndërsa tek procedura e negociuar e ku ka qenë i ftuar vetëm ky OE për të nënshkruar kontrate dhe negociuar këtë procedure ka ofruar çmimin ekstrem me të lart në vlerë 11.685.45 euro.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroj: Autoriteti Kontraktues për këtë AP ka vepruar në bazë të vendimit të OSHP-së me nr. 568/19 dhe njëherit Autoriteti Kontraktues pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për këtë tender.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Kam shqyrtuar të gjitha pretendimet e ankesës të gjitha i kam dhënë në ekspertizë dhe mbetem mbrapa raportit të dhënë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z.Fetoshi deklaroj: Duke pas parasysh të gjitha faktet në këtë seancë kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe ky AP të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Jashari deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhet poshtë ankesa e OE si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Në pyetjen e Kryetarit të Panelit drejtuar përfaqësuesit të AK-së: A keni kërkuar sqarime?

Përfaqësuesi i AK-së përgjigjet: Për herën e parë kemi kërkuar sqarime për të gjitha pozicionet.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Termovision "SH.P.K-Prishtinë "se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINS, nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,pasi që e ka shpallur fitues OE "Sabri Azemi B.I. 23 Prishtinë", po ashtu ankuesit ka pretenduar se AK duhet të ketë në konsideratë qëllimin e këtij ligji ku dihet se qëllim i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë . Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se qëllim i këtij neni është të sigurojnë mënyrë ma efikase,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen ,të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si OE i pa suksesshëm dhe shpallja fitues e OE. i cili ka ofertuar me çmim më të lirë është në harmoni me nenin 1 të LPP-së . Andaj konstatojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Termovision "SH.P.K-Prishtinë pretendon se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se dispozita e lartcekur ka të bej me trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve ,andaj trajtimi i OE ankues i pa suksesshëm nuk është diskriminues , por është transparente dhe në harmoni me nenin 7 të LPP-së.Duke u bazuar në këto fakte konstatojmë se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar ,sepse AK bazuar në arsyet e cekura më lart e ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmim më të lirë sipas poentimit dhe në atë mënyrë të gjithë OE i ka trajtuar në mënyrë të barabartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Termovision "SH.P.K-Prishtinë, se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se dispozita e lartcekur ka të bej me ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve . AK fillimisht pas pranimit të vendimit të OSHP-së me nr. 568/19 të datës 13.11.2019, ka themeluar komisionin e Ri-vlerësimit i cili ka vlerësuar dhe ka konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit . Andaj në harmoni me nenin 59 të këtij ligji e ka rekomanduar për kontratë OE të cilin e ka aprovuar edhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit, andaj konstatojmë se ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankues "Termovision "SH.P.K-Prishtinë se KUVENDI I KOMUNES i PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit e kishte përcaktuar kriterin për dhënien te kontratës, tenderi i përgjegjshëm me çmim më të lirë dhe te përshkrimi i çmimit i ka ndarë njësit duke i peshuar me

poentim. Ku me rastin e Ri-vlerësimit AK ka vepruar konform kriterit të paraparë me NJ.K. dhe D.T. dhe në harmoni me nenin 60 të LPP-së , duke e bere vlerësimin ofertave në baze te kriterit te lartcekur, andaj konstatojmë se ky pretendim është i pa bazuare.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Termovision “SH.P.K-Prishtinë, se KUVENDI I KOMUNES I PRISHTINES nuk ka respektuar nenin 61- të LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta . Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se sa i përket pretendimit lidhur me nenin 61 të LPP-së dhe “Rregullorja për Tenderët Jo –Normalisht të ulët (B57)”, për këtë pikë pretenduese kemi vendimin e OSHP-së përkatësisht vendimin me PSH.nr.590/19 të datës 13.11.2019 i cili ndër të tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar nga AK duhet të eliminohen praktikat kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e ofertuesit tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuara të bazohen në çmimin e ofertuar, e jo duke krahasuar çmimet me ofertuesit tjerë, sepse në rast kur kemi krahasimin e çmimeve me ofertat të ndryshme me njëra –tjetrën, atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët ku edhe gjen zbatim rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët. Apo, kur përcaktojmë kriterin ekonomikisht më të favorshëm ku varësisht nga pikët maksimale përcaktohet fituesi, pra te kriteri tenderi me çmim më të lirë të poentuar pavarësisht çmimit të ofertës për njësi sepse kemi të bëjmë me kontratë kornizë ku nuk kemi sasi indikative. Në këtë kuptim sqarohet se Rregullorja për tenderët abnormalisht të ulët gjen zbatim te kriteri “Çmimi më i ulët” por jo edhe te kriteri çmimi më i ulët i poentuar.

Paneli shqyrtues sqaron se ne rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës se dhënë, P.sh nëse pesha është dhënë kategorive te artikujve apo shërbimeve duke u bazuar ne raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj ne mënyrë te qarte se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale te AK-ës. kjo ne baze te interpretimit te KRPP-se te datës 10.12.2019 tek Pyetjet e shpeshta , pyetja nr.62.

Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se ky pretendim trajtohet si çështje e gjykuar “res judicata” sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të LPP-së dhe par. 3 të nenit 16 të Rregullores nr. 01/2017 së punës së OSHP-së, te bazuar në vendimin 590/19 të datës 13.11.2019 të nxjerr nga OSHP-ja.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht autoritet kontraktues ka respektuar edhe vendimi i OSHP –së PSH nr. 568/19 të datës 13.11.2019.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës
- 1x1 OE-“TERMOVISION SHPK”-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.